



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 08.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 1

DATË 24.08.2026 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë Vlorë- znj. Brunilda Mersini, Nënkryetare e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit - z.Skerdilaid Hunda, Sekretare e Këshillit Bashkiak –znj. Launela Dautaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.
(Në takim morrën pjesë 22 persona.)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Ju falenderoj që jeni pjesë e dëgjësave publike. Investimet që kanë qenë në fokus kanë të bëjnë kryesisht me parandalimin e përmytjeve, pasi kjo është një zonë historike dhe përmytjet shkaktojnë dëme ekonomike. Është kryer pastrimi i kanaleve të ujërave të larta. Në vitin 2027 do të kemi në fokus pastrimin e kanaleve, me qëllim evitimin e përmytjeve. Vëmendje do t’i kushtohet edhe Rrugës së Beut dhe një pjese të lagjes së vjetër, në vazhdim të Rrugës së Kuzum Babaisë. Jam e hapur të dëgjoj mendimet dhe sugjerimet tuaja.

Banor: Ka nevojë për ndërhyrje dhe rikonstruksion të Rrugës së Trenit të Vjetër.

Banor: Problem mbeten ujërat e bardha. Si mund të kalojë uji në Rrugën “Muharrem Rushiti”? Kjo rrugë ka nevojë urgjente për ndërhyrje deri te Kthesa e Llonxhës.

Banor: Te Vetëshërbimi ka problem me përmytjen e rrugës.



Banor: Përshëndetje. I keni dhënë një frymë të re Vlorës. Rruga “Faslli Zogaj” ka nevojë për asfaltim, si dhe kërkohet ndriçimi i rrugës midis zonës së Topanasë dhe “4 Heronjve”.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Kemi ndërhyrë në disa lagje dhe kjo zonë do të vijojë të jetë në vëmendje. Te shkallët e Kuzum Babait është realizuar ndriçimi. Problem mbetet hedhja e mbetjeve jashtë vendeve të caktuara.

Banor: Kërkohet spostimi i 4 topave dhe funksionimi i shatërvanit.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Do të bëjmë lulishte.

Banor: Lulet duhet të jenë të përhershme.

Banor: Punë e mirë për stacionin e autobusëve.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Në vijim do të jetë prioritet, me mbështetjen e Kryeministrit, vendosja e linjës elektrike, si dhe shtrimi i linjave.

Banor: Autobusët duhet të pajisen me kondicionerë. Gjithashtu, përballë Bashkisë që është jashtë funksionit.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Së shpejti do të vihet në funksion, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Banor: Duhet vendosur bordura te shkallët e Kuzum Babasë. Gjithashtu, ka nevojë për mbjellje pemësh.

Banor: Si do të funksionojë tregu?

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Do të ndiqen procedurat ligjore, procesi do të zgjasë.

Banor: Rruga te shkolla “4 Heronjtë”, që del përballë Bashkisë, ka nevojë për ndërhyrje.

Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatore për Njoftimi dhe Konsultim Publik

